Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit të Pavarur

POSTA SHQIPTARE Sh.a.

31 Dhjetor 2019

Përmbajtja

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR	**2**
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	**6**
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	**7**
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	**8**
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	**9**
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	**10**

TPA Albania Sh.p.k
Nipt: L31619012O
Str. Ibrahim Rugova
Pall. Shallivare,
Apt. 44, 1000 Tirana
Albania

M +355 (0) 6940 62631
T +355 (0) 422 34568
ilir.binaj@tpa-group.al
www.tpa-group.al

Albanian Audit Partners Shpk
L01405019O
Str. Sami Frashëri
Ndërtesa 19, Hyrja 8, kati 6,
Ap. 18, Tirana
Albania

M +355 (0) 6920 90030
T +355 (0) 422 58613
bbendo@aap-albania.com
www.aap-albania.com

Rovena Agolli
M01421008L
Str. Ibrahim Rugova
Kompleksi Green Park,
Hyrja 8, Tirana
Albania

M +355 (0) 68 200 7251
T +355 (0) 422 62444
agolliro.cons@gmail.com

Ilir Daiu
L91310004V
Str. Nikolla Jorgo,
Kulla 8, Hyrja 1,
Ap 10, Tirana
Albania

M +355 (0) 6920 73030

ilir.daiu@dk-audit.com
www.dk-audit.com

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Drejtimin dhe Aksionarin e Posta Shqiptare Sh.a.,

Opinioni me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a. (më poshtë "Shoqëria") që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe informacione të tjera sqaruese, të përfshira nga faqja 6 deri në faqen 32.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjeve të diskutuara në paragrafin "Baza për opinionin me rezervë", pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Posta Shqiptare Sh.a. me 31 dhjetor 2019 si dhe performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin me rezervë

1. Siç është paraqitur në Shënimin 8 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2019, inventarët paraqitet në vlerën 239,935 mijë lekë (2018: 220,670 mijë lekë). Ne u angazhuam si auditues të Shoqërisë mbas datës 31 Dhjetor 2019, dhe nuk kemi observuar numërimin fizik më 31 Dhjetor 2019 meqenëse kjo datë ka qenë para se ne të angazhoheshim si auditues të Shoqërisë, për rrjedhojë, ne nuk ishim në gjendje të krijonim siguri të arsyeshme për vlerën e paraqitur në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2019.

2. Siç është paraqitur në Shënimin 9 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2019, kërkesat e arkëtueshme tregtare janë në vlerë 1,045,487 mijë lekë (2018: 930,663 mijë lekë). Ne nuk ishim në gjendje të merrin konfirmime nga palët e treta në lidhje plotësinë dhe saktësinë e kësaj shumë. Shoqëria ka njohur një provigjon prej 15,712 mijë lekë, por nuk ka kryer një vlerësim për të gjitha balancat për mundësinë e arkëtimit dhe njohjen e humbjeve për borxhin e keq.

3. Siç është paraqitur në Shënimin 10 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2019, kërkesat e tjera të arkëtueshme paraqiten në vlerë 404,093 mijë lekë (2018: 354,803 mijë lekë) prej të cilave vlera prej 249,300 mijë lekë (2018: 252,638 mijë lekë) përfaqson llogari të arkëtueshme nga të tretë dhe punonjës. Ne nuk ishim në gjendje të merrin konfirmime nga palët e treta në lidhje plotësinë dhe saktësinë e kësaj shumë. Shoqëria ka njohur një provigjon prej 20,761 mijë lekë, por nuk ka kryer një vlerësim për të gjitha balancat e llogarisë kërkesat e tjera të arkëtueshme për mundësinë e arkëtimit të këtyre balancave dhe njohjen e humbjeve për borxhin e keq.

TPA Albania Sh.p.k
Nipt: L31619012O
Str. Ibrahim Rugova
Pall. Shallvare,
Apt. 44, 1000 Tirana
Albania

M +355 (0) 6940 62631
T +355 (0) 422 34568
ilir.binaj@tpa-group.al
www.tpa-group.al

Albanian Audit Partners Shpk
L01405019O
Str. Sami Frashëri
Ndërtesa 19, Hyrja 8, kati 6,
Ap. 18, Tirana
Albania

M +355 (0) 6920 90030
T +355 (0) 422 58613
bbendo@aap-albania.com
www.aap-albania.com

Rovena Agolli
M01421008L
Str. Ibrahim Rugova
Kompleksi Green Park,
Hyrja 8, Tirana
Albania

M +355 (0) 68 200 7251
T +355 (0) 422 62444
agolliro.cons@gmail.com

Ilir Daiu
L91310004V
Str. Nikolla Jorgo,
Kulla 8, Hyrja 1,
Ap 10, Tirana
Albania

M +355 (0) 6920 73030

ilir.daiu@dk-audit.com
www.dk-audit.com

4. Siç është paraqitur në Shënimin 12 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2019, gjendja e mjeteve monetare në arkë dhe likuiditeteve të tjera të cilat perbëhen nga pulla dhe letra me vlerë paraqiten repektivisht 864,992 mijë lekë (2018: 755,280 mijë lekë) dhe 227,443 mijë lekë (2018: 151,860 mijë lekë). Ne jemi kontraktuar si auditues pas datës 31 dhjetor 2019 dhe si rrjedhojë nuk morëm pjesë në numërimin e mjeteve monetare të realizuar nga Shoqëria në mbyllje të vitit ushtrimor, për rrjedhojë, ne nuk ishim në gjendje të krijonim siguri të arsyeshme për vlerën e paraqitur në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2019.

5. Siç është paraqitur në Shënimin 15 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2019, gjendja e llogarive tregtare të pagueshme paraqiten në vlerën 1,093,831 mijë lekë (2018: 474,907 mijë lekë). Ne nuk ishim në gjendje të merrin konfirmime të mjaftueshme nga palët e treta në lidhje plotësinë dhe saktësinë e kësaj shumë.

6. Siç është paraqitur në Shënimin 19 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2019, gjendja e llogarive të tjera të pagueshme paraqiten ne vlerën 1,540,062 mijë lekë (2018: 1,361,740 mijë lekë). Ne nuk ishim në gjendje të merrin konfirmime të mjaftueshme nga palët e treta në lidhje plotësinë dhe saktësinë e kësaj shumë. Për rrjedhojë, ne jemi në gjendje të vlerësojmë efektin që ndonjë korrigjim i mundshëm të tyre në pasqyrat financiare të shoqërisë të mbyllura me 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

7. Siç është paraqitur në Shënimin 26, shoqëria ka kryer rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale në 31 Dhjetor 2018 dhe e ka është regjistruar në librat kontabël më 1 Janar 2019 duke njohur një humbje prej 101,773 mijë Lekë. Humbja nga rënia në vlere e aktiveve si dhe shtesat përkatëse tek aktivet dhe tek rezerva e rivlerësimit duhet të njihej në datën e raportit vlerësimit.

8. Siç është paraqitur në Shënimin 29, më 31 dhjetor 2019 shoqëria është paditur në disa çështje ligjore që përfshijnë pretendime për një vlerë prej 71,177 mijë Lekë. Shoqëria nuk ka krijuar asnjë provigjon për këto çështje gjyqsore në lidhje me këto detyrime të mundshme në të ardhmen.

9. Siç është paraqitur në Shënimin 2.1, shoqëria nuk ka bërë implemtimin e SNRF 16 që ka ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Gjithashtu, në shënimet e pasqyrave financiare Shoqëria nuk ka paraqitur shënimet për instrumentat financiare në përputhje me SNRF 7 dhe shënimet për angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara në përputhje me SNK 37.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit Ndërkombëtar për Standardet e Etikës (Kodi i IESBA) dhe Kodit të Instituit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (Kodi i IEKA), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" të amenduar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

TPA Albania Sh.p.k
Nipt: L31619012O
Str. Ibrahim Rugova
Pall. Shallivare,
Apt. 44, 1000 Tirana
Albania

M +355 (0) 6940 62631
T +355 (0) 422 34568
ilir.binaj@tpa-group.al
www.tpa-group.al

Albanian Audit Partners Shpk
L01405019O
Str. Sami Frashëri
Ndërtesa 19, Hyrja 8, kati 6,
Ap. 18, Tirana
Albania

M +355 (0) 6920 90030
T +355 (0) 422 58613
bbendo@aap-albania.com
www.aap-albania.com

Rovena Agolli
M01421008L
Str. Ibrahim Rugova
Kompleksi Green Park,
Hyrja 8, Tirana
Albania

M +355 (0) 68 200 7251
T +355 (0) 422 62444
agolliro.cons@gmail.com

Ilir Daiu
L91310004V
Str. Nikolla Jorgo,
Kulla 8, Hyrja 1,
Ap 10, Tirana
Albania

M +355 (0) 6920 73030

ilir.daiu@dk-audit.com
www.dk-audit.com

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen Për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, per shënimet shpjeguese për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale perveç sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e proçesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë proçedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për proçesin e auditimit me qëllim hartimin e proçedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijëmësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijëmësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijëmësi.

TPA Albania Sh.p.k
Nipt: L31619012O
Str. Ibrahim Rugova
Pall. Shallvare,
Apt. 44, 1000 Tirana
Albania

M +355 (0) 6940 62631
T +355 (0) 422 34568
ilir.binaj@tpa-group.al
www.tpa-group.al

Albanian Audit Partners Shpk
L014050190
Str. Sami Frashëri
Ndërtesa 19, Hyrja 8, kati 6,
Ap. 18, Tirana
Albania

M +355 (0) 6920 90030
T +355 (0) 422 58613
bbendo@aap-albania.com
www.aap-albania.com

Rovena Agolli
M01421008L
Str. Ibrahim Rugova
Kompleksi Green Park,
Hyrja 8, Tirana
Albania

M +355 (0) 68 200 7251
T +355 (0) 422 62444
agolliro.cons@gmail.com

Ilir Daiu
L91310004V
Str. Nikolla Jorgo,
Kulla 8, Hyrja 1,
Ap 10, Tirana
Albania

M +355 (0) 6920 73030

ilir.daiu@dk-audit.com
www.dk-audit.com

- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Çështje tjetër

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018, janë audituar nga auditues të tjetër, raporti i të cilit i datës 8 Tetor 2019 shpreh një opinion me rezervë mbi pasqyrat financiare.

Datë 17 Dhjetor 2020

Albanian Audit Partners shpk
Bujar Bendo, Auditues Ligjor

Ilir Daiu, Auditues Ligjor

Rovena Agolli, Auditues Ligjor

TPA Albania shpk
Ilir Binaj, CPA, CGMA, Auditues Ligjor

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënimet	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
AKTIVET			
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale, neto	5	3,020,841,915	2,413,528,149
Aktive afatgjata jomateriale, neto	6	108,736,894	57,514,310
Aktive afatgjata financiare	7	450,000,000	450,000,000
Totali i aktiveve afatgjata		**3,579,578,809**	**2,921,042,459**
Aktive afatshkurtra			
Inventarët	8	239,935,033	220,669,790
Llogari te arketueshme tregtare	9	1,045,487,141	930,662,909
Llogari te tjera arketueshme	10	381,630,095	354,802,665
Parapagiem dhe shpenziem të shtyra	11	13,344,106	7,792,000
Mjete monetare dhe likuditete të tjera	12	2,658,808,944	2,189,724,439
Totali i aktiveve afatshkurtra		**4,339,205,319**	**3,703,651,803**
TOTALI I AKTIVEVE		**7,918,784,129**	**6,624,694,262**
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Kapitali			
Kapitali aksioner		3,006,363,000	3,006,363,000
Rezerva nga rivlerësimi		1,715,249,484	1,138,684,252
Rezerva ligjore		120,809,791	117,568,841
Rezerva te tjera		126,507	126,507
Fitime te pashperndara		343,501,377	245,855,685
Fitime te ushtrimit		-188,035,448	64,818,991
Totali i kapitalit	13	**4,998,014,712**	**4,573,417,276**
Detyrimet			
Tatim i shtyre	14	239,995,576	168,513,547
Totali i detyrimeve afatgjata		**239,995,576**	**168,513,547**
Llogari te pagueshme tregtare	15	1,093,830,707	474,907,062
Detyrime tatimore	16	36,986,082	32,364,825
Detyrime ndaj punonjesve	17	2,718,248	6,504,855
Grante dhe te ardhura te shtyra	18	7,176,717	7,247,008
Llogari te tjera te pagueshme	19	1,540,062,087	1,361,739,689
Totali i detyrimeve afatshkurtra		**2,680,773,840**	**1,882,763,439**
Totali i detyrimeve		**2,920,769,417**	**2,051,276,986**
TOTALI DETYRIMEVE DHEKAPITALIT		**7,918,784,129**	**6,624,694,262**

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 26 Nëntor 2020 dhe firmosur në emër të saj nga:

Laert Duraj
Administrator

Evis Brarri
Drejtor Ekonomik

REPUBLIKA E SHQIPËRISË POSTA SHQIPTARE SHA TIRANË

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

	Shënimet	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të ardhura	**20**	2,784,514,253	2,515,292,083
Të ardhura të tjera	**21**	1,431,470	91,683
Total të ardhura		**2,785,945,723**	**2,515,383,766**
Kostot operative			
Materiale të para dhe të konsumueshme	**22**	-383,371,168	-242,303,794
Shpenzime personeli	**23**	-1,399,759,134	-1,378,181,004
Shpenzimi zhvlerësimi dhe amortizimi	**5,6**	-244,303,186	-162,137,667
Shpenzime të tjera	**24**	-865,550,624	-628,359,064
Totali i shpenzimeve operative		**-2,892,984,112**	**-2,410,981,529**
Fitimi/(humbja) neto nga operacionet		**-107,038,389**	**104,402,237**
Të ardhura/(shpenzime) financiare, neto	**25**	43,240,062	-9,606,102
Humbje nga rivlerësimi i aseteve, neto	**26**	-101,773,776	-
Fitimi/(humbja) para tatimit		**-165,572,103**	**94,796,135**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	**27**	-22,463,344	-29,977,144
Fitim/(humbja) per vitin		**-188,035,448**	**64,818,991**
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse			
Rritja e rezervës së rivlerësimit	**13**	686,691,280	**-**
Tatim fitime të shtyra nga rivlerësimi i aktiveve	**14**	-71,482,029	-1,571,220
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse		**427,173,803**	**63,247,771**

Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare

	Shënime	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytezimit			
Fitimi/(humbja) para tatimit		**-165,572,103**	**94,796,135**
Rregullime per:			
Amortizimi	**5,6**	244,303,186	162,088,345
Zhvlerësimi	**26**	101,773,776	-
Nxjerrja jashtë përdorimit, sistemime		-5,326,539	27,407,411
Fitimi nga veprimtarite e shfrytëzimit para rregullimeve në kapitalin qarkullues		**175,178,319**	**284,291,891**
(Rritje)/ulje në inventar		-19,265,243	-41,604,900
(Rritje)/ulje në llogari të arkëtueshme dhe të tjera		-141,651,662	61,352,696
(Rritje)/ulje në parapagime, shpenzime të shtyra		-5,552,106	-7,792,000
Rritje/(ulje) në llogari të pagueshme dhe të tjera		798,080,693	-168,501,156
Rritje/(ulje) në grante dhe të ardhura të shtyra		-70,291	-3,688,159
Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit		**806,719,709**	**124,058,372**
Tatimi mbi fitimin i paguar		-22,463,344	-29,977,144
Fluksi monetar neto nga veprimtarite e shfrytezimit		**784,256,365**	**94,081,228**
Fluksi monetar nga veprimtarite e investimit			
Blerje aktivesh afatgjata materiale	**5**	-314,172,139	-154,879,636
Blerje aktivesh afatgjata jo-materiale	**6**	-999,721	-
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga/ (perdorur ne) veprimtarite e investimit		**-315,171,859**	**-154,879,636**
Fluksi monetar nga veprimtarite financiare			
Pagesa dividenti	**13**	-	-1,382,433
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga/ (perdorur ne) veprimtarite financiare		**-**	**-1,382,433**
Rritja/(ulja) neto e mjeteve monetare		469,084,506	-62,180,841
Mjete monetare me 1 Janar		2,189,724,439	2,251,905,280
Mjete monetare me 31 Dhjetor	**12**	**2,658,808,944**	**2,189,724,439**

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital

	Kapitali i regjistruar	Rezerva të tjera	Rezerva ligjore	Rezerva rivlerësimi	Fitimi te mbartura	Total
Gjendja me 01 Janar, 2018	3,008,624,000	126,507	116,877,624	1,199,012,192	190,395,131	4,515,035,454
Të ardhurat gjithpërfshirëse:						
Fitimi i vitit	-	-	-	-	64,818,991	64,818,991
Te ardhura te tjera gjithperfshirese	-	-	-	-	-1,571,220	-1,571,220
Totali i të ardhurave gjithperfshirese pas taksave	**-**	**-**	**-**	**-**	**63,247,771**	**63,247,771**
Rimarrje rezervash rivlerësimi për amortizimin vjetor	-	-	-	59,105,424	59,105,424	-
Zvogelim kapitali	-2,261,000	-	-	-1,222,516	-	-3,483,516
Rritje rezervash	-	-	691,217	-	-691,217	-
Dividente	-	-	-	-	-1,382,433	-1,382,433
Gjendja me 31 Dhjetor 2018	**3,006,363,000**	**126,507**	**117,568,841**	**1,138,684,252**	**310,674,676**	**4,573,417,276**
Gjendja me 01 Janar, 2019	3,006,363,000	126,507	117,568,841	1,138,684,252	310,674,676	4,573,417,276
Sistemim i rezervës negative të rivlerësimit të mbartur	-	-	-	18,462,269	-18,462,269	-
Sistemime për asetet jashtë përdorimit periudhat e mëparshme	-	-	-	-9,308,890	9,308,890	-
Të ardhurat gjithpërfshirëse:						
Fitimi (humbja) e vitit	-	-	-	-	-188,035,448	-188,035,448
Rivlerësimi i aseteve	-	-	-	686,691,280	-	686,691,280
Tatim fitimi i shtyre për rivlerësimin e aseteve	-	-	-	-	-89,373,943	-89,373,943
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse nga rimarrja e tatimit të shtyrë	-	-	-	-	17,891,914	17,891,914
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse pas taksave	**-**	**-**	**-**	**686,691,280**	**-259,517,477**	**427,173,803**
Rimarrje rezervash rivlerësimi për amortizimin vjetor	-	-	-	-116,703,060	116,703,060	-
Rimarrje rezervash rivlerësimi për nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	-	-2,576,367		-2,576,367
Rritje rezervash	-	-	3,240,950	-	-3,240,950	-
Dividente	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2019	**3,006,363,000**	**126,507**	**120,809,791**	**1,715,249,484**	**155,465,930**	**4,998,014,712**

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Posta Shqiptare Sh.a. ("Shoqëria") është Shoqeri Anonime e krijuar me datën 3 Shkurt 1992. Aksioneri i vetëm i shoqërisë është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit nr.7638 datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe në vijim nga ligji Nr.9901 dt 14.04.2008, si edhe statusi i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi. Shoqëria është gjithashtu institucion financiar jo bankë e liçensuar si e tillë nga Banka Qëndrore e Shqipërisë dhe raporton në mënyrë specifike për këtë qëllim.

Selia e Shoqërisë është në Rr."Reshit Çollaku", Tiranë, Shqipëri. Shoqëria është regjistruar në autoritetet fiskale me Numer Identifikimi të Personit të Tatueshëm (NIPT) J61924007N.

Aktiviteti kryesor përfshin kryesisht shërbimet postare, por Shoqëria ushtron edhe aktivitet financiar. Administrator i Shoqërisë është Z. Laert Duraj. Më 31 Dhjetor 2019 shoqëria kishte 2,494 punonjës (31 Dhjetor 2018: 2,433 punonjës).

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitit e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 26 Nëntor 2020.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Politikat kryesore të kontabilitetit të adaptuara në përgatitjen e pasqyrave financiare, janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike. Monedha e raportimit është Leku Shqiptar ("Lek") që është gjithashtu edhe monedha funksionale.

Shoqëria mban librat e saj kontabël dhe publikon pasqyrat e saj statutore financiare në përputhje me Ligjin 25/2018 datë 10 Maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Shoqëria i ka përgatitur pasqyrat e saj financiare në përputhje me SNRF, të cilat u bënë të detyrueshëm në Shqipëri në bazë të vendimit të Ministrisë së Financave Nr. 65, dt. 05.05.2008, "Per publikimin dhe zbatimin e detyrueshem të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, të përkthyera në gjuhen shqipe".

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijueshmërisë, që supozon se Shoqëria do të jetë në gjendje të rimarrë aktivet e saj dhe të shlyejë të gjitha detyrimet në bazë të rrjedhës normale të aktivitetit. Aktivet financiare dhe detyrimet financiare netohen kundrejt njëra tjetrës dhe shuma neto raportohet në pasqyren e pozicionit financiar vetëm kur ekziston nje e drejtë ligjerisht e zbatueshme për të netuar shumat e njohura dhe ka qëllim shlyerjen e tyre mbi baze neto, ose të realizoje aktivet dhe të shlyeje detyrimet në të njëjtën kohe. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk netohen në pasqyren e të ardhurave e shpenzimeve, përveç nëse kërkohet ose lejohet nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet e tyre, dhe sië parashikohet në mënyre specifike në politikat kontabël të Shoqërisë.

2.1. Standarde, ligje, interpretime dhe amendime efektive në periudhen aktuale

Politikat kontabël të adoptuara janë konsistente me politikat e vitit të mëparshëm me përjashtim të SNRF-ve të ndryshuara, të cilat janë bëre efektive në datën 1 janar 2019:

- SNRF 16 Qiratë
- KIRFN 23 Interpretimi - Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit Mbi te Ardhurat
- Ndryshime te SNRF 9: Elemente parapagimi me kompensim negativ
- Ndryshimet në SNK 19: Amendamenti, Kufizimet, ose Shlyerja e Planit
- Ndryshimet në SNK 28: Interesat afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta
- Përmirësime vjetore të SNRF-ve, Cikli 2015-2017
- Ligji i Ri per Kontantabilitetin ne Shqiperi

Standardet e reja, ndryshimet dhe ligji i ri i kontabilitetit, kanë qenë të detyrueshme për tu aplikuar për herë të parë duke filluar nga 1 Janar 2019 në pasqyrat financiare vjetore te Shoqërisë. Natyra dhe ndikimi i çdo standardi dhe ndryshimi është përshkruar si vijon:

- SNRF 16 – Qiratë
BSNK publikoi standardin e ri për kontabilizimin e qirave - SNRF 16 Qiratë në Janar 2016. Standardi i ri nuk ndryshon shumë kontabilizimin e qirave nga qiradhënesit. Megjithatë, kërkon që qiramarresit të njohin në bilancin e tyre kontabël te gjitha qiratë si detyrime si dhe aktivet korespnduesese. Qiramarrësit duhet të përdorin një model të vetëm për njohjen e të gjitha qirave, por do të kenë opsionin të mos njohin qiratë afatshkurtra ose qiratë për aktive me vlera të vogla. Në pergjithësi, modeli i njohjes do jetë i ngjashëm me atë që përdoret aktualisht për kontabilizimin e qirave financiare, me interesin dhe shpenzimin e amortizimit të njohur në zëra të vecantë në pasqyrën së fitimit ose humbjes. SNRF 16 hyri në fuqi ne 1 Janar 2019. Natyra dhe efektet e adoptimit të këtij standardi te ri jane pershkruar me poshte. Shoqëria adoptoi SNRF 16 duke perdorur metoden retrospektive te modifikuar me datë te aplikimit fillestar ne 1 Janar 2019. Sipas metodes retrospektive te modifikuar (alternativa 2) detyrimi i qerase matet duke skontuar pagesat e mbetura te qerase me normen rritëse te interesit të huamarrjes sipas afatit te qerase. Ky standard megjithëse ka ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqerisë nuk është implementuar.

- KIRFN 23 Interpretimi - Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit Mbi te Ardhurat
Interpretimi trajton kontabilitetin për tatimin mbi të ardhurat kur trajtimet tatimore përfshijnë pasiguri që ndikojne në zbatimin e SNK 12 dhe nuk zbatohet për tatimet ose taksat jashtë fushëveprimit të SNK 12 dhe as nuk përfshin në mënyrë specifike kërkesa lidhur me interesa dhe penalitete që lidhen me trajtimin e pasigurt tatimor. Interpretimi trajton në mënyrë specifike sa vijon:

- Nëse një njësi ekonomike i konsideron trajtimet e pasigurta tatimore veç e veç.
- Supozimet që një njësi ekonomike bën në lidhje me ekzaminimin e trajtimeve tatimore nga autoritetet tatimore
- Si një njësi ekonomike përcakton fitimin e tatueshëm (humbje tatimore), bazat tatimore, humbjet tatimore të papërdorura, kreditë tatimore të papërdorura dhe normat tatimore
- Si një njësi ekonomike i konsideron ndryshimet në fakte dhe rrethana.

Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse duhet të konsiderojë çdo trajtim tatimor të pasigurt veçmas ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera të pasigurta tatimore. Duhet te ndiqet qasja që parashikon më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Interpretimi është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2019. Interpretimi nuk pati ndikim në pasqyrat financiare të Shoqerisë.

- Ndryshime te SNRF 9: Elemente parapagimi me kompensim negativ
Sipas SNRF 9, një instrument borxhi mund të matet me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, me kusht që flukset monetare kontraktuale të jenë "vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të mbetur" (kriteri i SPPI) dhe instrumenti mbahet brenda nje model biznesi te përshtatshëm për këtë klasifikim. Ndryshimet në SNRF 9 sqarojnë se një aktiv financiar kalon kriterin e SPPI pavarësisht nga ngjarja ose rrethana që shkakton ndërprerjen e parakohshme të kontratës dhe pavarësisht se cila pale paguan ose merr kompensim të arsyeshëm për përfundimin e parakohshëm të kontratës. Ndryshimet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive dhe hynë në fuqi që nga 1 janari 2019. Këto ndryshime nuk paten ndikim në pasqyrat financiare të Shoqerisë.

2.1 Standarde, interpretime dhe amendime efektive ne periudhen aktuale (vazhdim)

- Ndryshimet në SNK 19: Amendamenti, Kufizimet, ose Shlyerja e Planit

Ndryshimet në SNK 19 adresojnë kontabilitetin kur një ndryshim, kufizim ose shlyerje plani ndodh gjatë një periudhe raportuese. Ndryshimet specifikojnë se kur një ndryshim, kufizim ose shlyerje plani ndodh gjatë periudhës raportuese vjetore, një njësi ekonomike duhet të:

- Përcaktoni koston aktuale të shërbimit për pjesën e mbetur të periudhës pas ndryshimit, kufizimit ose shlyerjes së planit, duke përdorur supozimet aktuariale të përdorura për rivlerësimin e pasivit neto të përfitimit të definuar (aktive) që reflekton përfitimet e ofruara sipas planit dhe aktivet e planit pas asaj ngjarjeje
- Përcaktoni interesin neto për pjesën e mbetur të periudhës pas ndryshimit, kufizimit ose shlyerjes së planit duke përdorur: detyrimin neto të përfitimeve të përcaktuara (aktive) që pasqyron përfitimet e ofruara sipas planit dhe aktiveve të skemës pas asaj ngjarjeje; dhe norma e skontimit e përdorur për të rimatuar atë pasiv neto të përfitimeve të përcaktuara (aktive).

Ndryshimet gjithashtu sqarojnë se një njësi ekonomike përcakton së pari çdo kosto të shërbimit të shkuar, ose një fitim ose humbje në shlyerje, pa marrë parasysh efektin e tavanit të aktivit. Kjo shumë njihet në fitim ose humbje. Një njësi ekonomike pastaj përcakton efektin e tavanit të aktivit pas ndryshimit, kufizimit ose shlyerjes së planit.

Çdo ndryshim në këtë efekt, duke përjashtuar shumat e përfshira në interesin neto, njihet në të ardhura e tjera gjithëperfshirëse. Ndryshimet zbatohen për ndryshimet, kufizimet ose shlyerjen e planit që ndodhin në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon më ose pas 1 janarit 2019. Këto ndryshime nuk patën ndikim në pasqyrat financiare të Shoqerisë. Këto amendime mund të zbatohen për ndryshime, kufizime ose shlyerje te ardhshëm të planit të Shoqërisë.

- Ndryshimet në SNK 28: Interesat afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta

Ndryshimet sqarojnë që një njësi ekonomike që zbaton SNRF 9 për interesat afatgjatë në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët në të cilën nuk aplikohet metoda e kapitalit neto, por që në thelb përbëjnë një pjesë të investimit neto në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët (afatgjatë interesat). Ky sqarim është i rëndësishëm sepse nënkupton që modeli i pritur i humbjes së kredisë në SNRF 9 zbatohet për interesa të tilla afatgjata. Ndryshimet gjithashtu sqaruan se, në zbatimin e SNRF 9, një njësi ekonomike nuk merr parasysh humbjet e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët, ose ndonjë humbje nga zhvlerësimi në investimet neto, të njohura si rregullime të investimit neto në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët që lindin nga zbatimi i SNK 28 Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta. Amendamentet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive dhe të jenë në fuqi nga 1 janari 2019. Meqenëse Shoqëria nuk ka interesa të tillë afatgjatë në shoqërinë e saj dhe sipërmarrjen e përbashkët, ndryshimet nuk kanë ndikim në pasqyrat e saj financiare.

Përmirësime vjetore të SNRF-ve, Cikli 2015-2017 (leshuar ne Dhjetor 2017)

Keto permiresime përfshijnë:

- SNRF 3 Kombinimet e Biznesit

Amendamentet sqarojnë se kur një njësi ekonomike merr kontrollin e një biznesi që është një operacion i përbashkët, ajo zbaton kërkesat për një kombinim biznesi të arritur në faza, duke përfshirë rivlerësimin e interesave të mbajtura më parë në aktivet dhe pasivet e operacioneve të përbashkëta me vlerë të drejtë. Duke vepruar kështu, blerësi e rimat të gjithë interesin e mbajtur më parë në operacionin e përbashkët. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime në kombinimet e biznesit për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon më ose pas 1 janarit 2019. Këto ndryshime nuk kanë ndikim ne pasqyrat financiare të Shoqërisë por mund të zbatohen për kombinimet të ardhshme të biznesit.

2.1 Standarde, interpretime dhe amendime efektive ne periudhen aktuale (vazhdim)

- SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta

Një palë që merr pjesë, por nuk ka kontroll të përbashkët, një operacion i përbashkët mund të marrë kontroll të përbashkët të veprimtarisë e cila përbën një biznes siç përcaktohet në SNRF 3. Amendamentet sqarojnë se interesat e mbajtura më parë në atë operacion të përbashkët nuk rimaten. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime në transaksionet në të cilat ajo fiton kontroll të përbashkët në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon në ose pas 1 janarit 2019. Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.

- SNK 12 Tatimi mbi Fitimin

Ndyshimet sqarojnë se pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividentëve lidhen më drejtpërdrejt me transaksionet e mëparshme ose ngjarjet që gjenerojnë fitime të shpërndara sesa me shpërndarjet tek pronarët. Prandaj, njësia ekonomike njeh pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve në fitim ose humbje, të ardhura të tjera gjitheperfshirese ose kapital sipas menyres se ku njësia ekonomike fillimisht i ka njohur ato transaksione ose ngjarje të mëparshme. Njësia ekonomike zbaton këto ndryshime për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Kur një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime per here te pare, ajo i zbaton ato tek tatimi mbi të ardhurat i dividendëve të njohur në ose pas fillimit të periudhës më të hershme krahasuese. Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.

- SNK 23 Kostot e Huamarrjes

Ndryshimet sqarojnë që një njësi ekonomike trajton si pjesë e huamarrjes së përgjithshme çdo huamarrje të bërë fillimisht për të zhvilluar një aktiv të kualifikuar kur në tërësi të gjitha aktivitetet e nevojshme për përgatitjen e atij aktivi për përdorimin ose shitjen e synuar janë të perfunduara.Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime në kostot e huamarrjes të bëra në ose pas fillimit të periudhës raportuese vjetore në të cilën njësia ekonomike i zbaton këto ndryshime. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019, aplikimi më hershëm është i lejueshëm. Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.

- Ligji i Ri per Kontantabilitetin në Shqipëri

Në vijim të punës që po bën qeveria shqiptare në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar më datë 10 maj 2018 ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" (më poshtë "Ligji i ri për kontabilitetin" ose "Ligji i ri"), i cili shfuqizon ligjin e mëparshëm nr. 9228, datë 29.4.2004.

Ligji i ri për kontabilitetin është përafruar pjesërisht me Direktivën 2013/34 të Bashkimit Evropian dhe qëllimi është përafrimi i plotë i tij në vitin 2028. Ligji i ri hyri në fuqi më datë 1 janar 2019. Aplikimi i Ligjit te ri nuk ka ndikim në pozicionin financiar dhe performancën e Shoqërise dhe në menyren e pariqitjes se pasqyrave finaciare.

2.2 Standarte te emetuara por qe ende nuk kane hyre ne fuqi dhe nuk jane adoptuar

Standardet dhe interpretimet e emetuara, por qe nuk kane hyre ende ne fuqi, deri ne datën e deklarimit te pasqyrave financiare te Shoqërisë, jane pasqyruar me poshte. Shoqëria synon te adoptoje keto standarde, nese jane te aplikueshme, kur ato te behen efektive.

- SNRF 17 Kontratat e sigurimit

Në Maj 2017, BSNK publikoi SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (SNRF17), një standard i ri kontabël gjithpërfshirës për kontratat e sigurimeve që mbulon njohjen dhe matjen, prezantimin dhe shënimet shpjeguese. Pasi të bëhet efektiv, SNRF 17 do të zëvendësojë SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 4) që është nxjerrë në vitin 2005. SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (dmth., jetë, jo-jetë, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe risigurimi), pavarësisht nga lloji i subjekteve që i lëshojnë ato, si dhe për disa garanci dhe instrumente financiare me karakteristika të pjesëmarrjes diskrecionare.

2.2 Standarte te emetuara por qe ende nuk kane hyre ne fuqi dhe nuk jane adoptuar (vazhdim)

Do të ketë disa përjasthime nga objektivi. Objektivi i përgjithshëm i SNRF 17 është të sigurojë një model kontabiliteti për kontratat e sigurimit që të jetë më i dobishëm dhe i qëndrueshëm për siguruesit. Në kontrast me kërkesat e SNRF 4, të cilat bazohen kryesisht në politikat e mëparshme të kontabilitetit, SNRF 17 ofron një model gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimeve, duke mbuluar të gjitha aspektet përkatëse të kontabilitetit. SNRF 17 hyn në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2021 dhe zbatimi i tij kërkon paraqitjen e vlerave krahasuese të periudhave të mëparshme. Aplikimi i më hershëm është i lejueshëm me kusht që Shoqëria të aplikojë SNRF 9 dhe SNRF 15 më ose përpara datës së aplikimit të SNRF 17. Ky standard nuk është i aplikueshëm për Shoqërinë.

- Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8: Përkufizimi i materialitetit

Në tetor 2018, BSNK publikoi ndryshimet e SNK 1 Paraqitja e pasqyrave financiare dhe SNK 8 Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet për të përafruar përkufizimin e 'materialitetit' ndërmjet standardeve dhe për të sqaruar disa aspekte të përkufizimit. Përkufizimi i ri shprehet se 'informacioni është material nëse përjashtimi, deklarimi i gabuar ose fshehja e tij mund të ndikojë në menyrë të arësyeshme vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të përgjithshme marrin bazuar në ato pasqyra financiare, të cilat japin informacion mbi një njësi specifike.

- Ndryshimet në SNRF 3: Përkufizimi i biznesit

Në tetor 2018, BSNK publikoi ndryshimet në përkufizimin e biznesit në SNRF 3 Kombinimet e biznesit për të ndihmuar njësitë të përcaktojnë nëse një set aktivesh të përvetësuara përbën një biznes ose jo. Aty sqarohet minimumi i kërkesave për një biznes, hiqet vlerësimi nëse një pjesëtar i tregut është në gjëndje të zëvendësoje ndonjë element që mungon, dhe shtohen udhëzimet për të ndihmuar njësitë të vlerësojnë nëse një proces i përvetësuar është thelbësor, ngushton përkufizimet e biznesit dhe rezultateve, dhe prezanton një test opsional të përqëndrimit të vlerës së drejtë. Shembuj të rinj ilustrues janë prezantuar bashkë me ndryshimet. Meqë ndryshimet aplikohen në mënyrë prospektive në transaksionet ose ngjarjet që ndodhin në ose pas datës së parë të aplikimit Shoqëria nuk do të ndikohet nga këto ndryshime në datën e tranzicionit

- Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28: Shitja ose kontributi i Aktiveve nga investitori tek pjesëmarrja e tij ose sipërmarrja e përbashkët

Ndryshimet adresojnë konfliktin midis SNRF 10 dhe SNK 28 për trajtimin e humbjes së kontrollit mbi një filial që shitet ose kontribuohet tek një pjesëmarrje ose sipërmarrje e përbashkët. Ndryshimet sqarojnë se fitimi ose humbja që rezulton nga shitja ose kontributi i aktiveve që përbëjnë një biznes, siç përcaktohet në SNRF 3, nga investitori tek pjesëmarrja e tij ose sipërmarrja e përbashkët, njihet plotësisht. Çdo fitim ose humbje që rezulton nga shitja ose kontributi i aktiveve që nuk përbëjnë një biznes, njihet vetëm në masën e interesave të investitorëve të palidhur në pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët. BSNK ka shtyrë datën efektive të këtyre ndryshimeve për një kohë të pacaktuar, por një njësi ekonomike që i aplikon ndryshimet me heret duhet t'i zbatojë ato në mënyrë prospektive. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqerisë.

Shoqëria ka zgjedhur të mos i implementoje këto standarde, rishikimeve dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Shoqëria parashikon qe adoptimi i ketyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do te kete ndikim material ne pasqyrat financiare te Entitetit ne periudhen e aplikimit fillestar.

3. Gjykime dhe vlerësime të rëndësishme kontabile

Në aplikimin e politikave kontabel te Shoqërisë, që përshkruhen në Shënimin nr 4, Drejtimit i kërkohet që të bëjë gjykime, çmuarje, dhe supozime për vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve që nuk jane qartesisht te dukshme nga burime te tjera. Çmuarjet dhe supozimet e lidhura me to jane te bazuara ne eksperiencen historike dhe faktore te tjere qe konsiderohen te rendesishem. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto cmuarje.

Çmuarjet dhe supozimet e lidhura me to jane rishikuar ne menyre te vazhdueshme. Ndryshimet ne çmuarjet kontabël do te njihen ne periudhen ne te cilen cmuarja është rishikuar nqs rishikimi ndikon vetem ate periudhe ose ne periudhen e rishikimit dhe ne periudha te ardhshme nqs rishikimi ndikon periudhen aktuale dhe ato te ardhme.

Pasiguria ne gjykime

Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Humbjet nga zhvlerësimi do te njihen ne vleren ne te cilen vlera kontabel e aktiveve ose e njesise gjeneruese te parase tejkalon vleren e rikuperueshme. Kur percaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlerëson cmimet e pritshme dhe flukset e parase nga çdo njesi gjeneruese e parase dhe percakton nje norme interesi te pershtatshme kur llogaritet vlera aktuale e ketyre flukseve te parase.

Jeta e dobishme e aktiveve te amortizueshme

Drejtimi rishikon rregullisht jetet e dobishme të aktiveve të amortizueshme ne datën e pasqyres se pozicionit financiar. Drejtimi vlerëson nese jeta e percaktuar si e dobishme e aktiveve, perfaqeson dobishmerine e pritur te aktiveve. Vlerat kontabel e ketyre aktiveve analizohet në Shënimin 5 dhe 6. Megjithate, rezultatet faktike mund te ndryshojne per shkak te vjeterimit teknologjik.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Zhvlerësimi i llogarive te arketueshme dhe te tjera te arketueshme

Shoqëria llogarit zhvlerësimin per llogarite e arketueshme tregtare dhe per llogarite e tjera te arketueshme bazuar ne humbjet e vlerësuara qe rezultojne nga paaftesia e klienteve per te bere pagesat e kerkuara.Vlerësimi është bazuar ne vjetërimin (aging) e gjendjes se llogarive te arketueshme dhe pervojen historike te shlyerjes, kreditin e konsumatoreve dhe ndryshimeve ne aspektin e pagesave te konsumatoreve gjate vlerësimit te humbjes nga zhvlerësimi per llogarite e dyshimta. Keto përfshijnë supozime mbi sjelljen e konsumatoreve dhe mbledhjen e mjeteve monetare te ardhshme qe rezulton prej saj. Nese gjendja financiare e klienteve do te perkeqesohej, zhvlerësimi aktual i llogarive te arketueshme ekzistuese mund te jete me i larte se sa pritet dhe mund te tejkaloje nivelin e humbjeve nga zhvlerësimi te njohura deri tani.

Inventari

Inventari është paraqitur me vleren me te ulet midis kostos dhe vlerës se realizueshme neto. Gjate percaktimit te vlerës se realizueshme neto, drejtimi merr parasysh evidencat me objektive/te dhenat e disponueshme per kryerjen e vlerësimeve.

4. Përmbledhje e politika të rëndësishme kontabile

4.1 Transaksionet ne monedha te huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj jane te konvertuara ne Lekë dhe regjistrohen duke perdorur kursin e kembimit ne datën e transaksionit. Aktivet monetare dhe zera te tjere jo monetare ne monedhe te huaj rivlerësohen ne Lekë me kursin e kembimit te Bankës së Shqipërisë ne datën e fundit te periudhes raportuese. Diferencat e kembimit valutor jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese te Shoqërisë. Kursi zyrtar i kembimit per monedhat kryesore per perkthimin e zerave te pozicionit financiar te shprehur ne monedhe te huaj paraqiten si vijon (ne Lekë):

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1 EUR	121.77	123.42
1 USD	108.64	107.82
1 CHF	112.30	109.60
1 GBP	143.00	137.42
1 SDR	150.23	149.95

4.2 Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale jane paraqitur me vleren e drejtë në datë e rivlerësimit duke zbritur se amortizimit te akumuluar dhe/ose humbjeve te akumuluara nga zhvlerësimi, nese ka.

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale janë paraqitur fillimisht me kosto duke zbritur zhvlerësimet dhe amortizimet e akumuluar. Kjo kosto historike perfshin shpenzimet qe lidhen direkt me blerjen e aktiveve. Kosto e aktiveve te ndertuara vete perfshin koston e lendeve te para dhe punes, dhe çdo kosto tjeter qe lidhet direkt me sjelljen e aktivit ne gjendje pune, kostot e çmontimit dhe heqjes se mjeteve dhe rikonstruksioni i vendit ku ato janë vendosur.

ii. Kostot e mëpashme

Kostot shtese jane perfshire ne vleren e aktivit ose njihet si nje aktiv i veçante, sipas nevojes, vetem kur është e mundur qe perfitimet ekonomike te ardhshme te lidhura me artikullin do te hyne ne Shoqeri dhe kostoja e artikullit mund te matet me besueshmeri. Te gjitha riparimet dhe mirembajtjet e tjera, ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese gjate periudhes financiare ne te cilen ato kryhen.

iii. Amortizimi

Normat vjetore te amortizimit te aplikuara jane si me poshte:

Aktivet afatgjata materiale	Normat e zhvlerësimit %		Metoda e zhvlersimit
	2019	2018	
Ndertesa	5	5	Mbi vlerën e mbetur
Makineri dhe pajisje	20	20	Mbi vlerën e mbetur
Mjete transporti	20	20	Mbi vlerën e mbetur
Mobilje dhe orendi	20	20	Mbi vlerën e mbetur
Paisje elektronike	25	25	Mbi vlerën e mbetur
AAM në proçes	Jo/aplikueshme	Jo/aplikueshme	

Vlerat e mbetura dhe jeta e perdorimit te aktiveve jane rishikuar, dhe rregulluar nese është e pershtatshme, ne datën perkatese te pozicionit financiar. Vlera kontabel e nje aktivi është zhvlerësuar menjehere ne vleren e tij te rikuperueshme nese vlera kontabel e aktivit është me e madhe sesa shuma qe vlerësohet te rikuperohet.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet e aktiveve, janë përcaktuar duke krahasuar te ardhurat me vleren e aktivit. Këto jane te perfshira ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese si shpenzime.

iv. Metoda e rivlerëzimit

Shoqëria ka zgjedhur metodën e rivlerësimit për të matur vlerën e aktiveve afatgjata materiale. SNK 16 Aktivet Afatgjata Materiale kërkon që nëse një kompani zgjedh metodën e rivlerësimit për matjen e aktiveve me vlerën e drejtë, atëherë rivlerësimi i aktiveve duhet të kryhet me një rregullsi të mjaftushme që të sigurojë që vlerat kontabël të mos ndryshojnë materialisht nga vlera e drejtë.

4.3 Aktivet afatgjata jo-materiale

Aktivet afatgjata jomateriale përfshijnë programe kompjuterike, liçensa dhe të drejta për përdorim. Aktivet afatgjata jomateriale jane paraqitur me vleren e drejtë në datë e rivlerësimit duke zbritur se amortizimit te akumuluar dhe/ose humbjeve te akumuluara nga zhvlerësimi, nese ka.

i. Njohja dhe matja

Programe kompjuterike, liçensa dhe të drejta për përdorim janë paraqitur fillimisht me kosto duke zbritur zhvlerësimet dhe amortizimet e akumuluar.

ii. Shpenzimet e mëpashme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetem kur është e mundur qe perfitimet ekonomike te ardhshme te lidhura me aktivin për të cilin lidhen dhe mund te matet me besueshmeri. Te gjitha riparimet dhe mirembajtjet e tjera, ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese gjate periudhes financiare ne te cilen ato kryhen si shpenzime.

iii. Amortizimi

Normat vjetore te amortizimit te aplikuara jane si me poshte:

Aktivet afatgjata jomateriale	Normat e zhvlerësimit %		Metoda e zhvlersimit
	2019	2018	
Programe kompjuterike	25	25	Mbi vlerën e mbetur
Liçensa dhe të drejta për përdorim	15	15	Lineare
AAJM në proçes	Jo/aplikueshme	Jo/aplikueshme	

4.4 Zhvlerësimet

Aktivet jo-financiare

Vlerat kontabel e aktiveve jo-financiare te Shoqërisë rishikohet ne datën e raportimit per te percaktuar nese ka evidenca per zhvlerësim. Nese ka evidenca te tilla, atehere vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Shuma e rikuperueshme është me e madhja midis vlerës se drejte minus kostot per shitje dhe vlerës ne perdorim. Ne vlerësimin e vlerës ne perdorim, flukset e ardhshme te mjeteve monetare jane skontuar ne vleren e tyre aktuale duke perdorur nje norme skontimi para taksave qe reflekton vlerësimin aktual te tregut per vleren ne kohe te parase dhe rreziqet specifike per aktivin per te cilat vlerësimet e flukseve monetare te ardhshme nuk jane rregulluar. Humbja nga zhvlerësimi njihet nese vlera kontabel e nje aktivi ose e njesise gjeneruese te mjeteve monetare tejkalon vleren e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese (ne fitim ose humbje).

Aktivet financiare

Nje aktiv financiar qe nuk mbahet me vleren e drejte nepermjet fitimit ose humbjes, vlerësohet ne çdo datë raportimi per te percaktuar nese ka nje evidence objektive se ai është zhvlerësuar. Shoqëria njeh një zhvlerësim për humbjet e pritshme të kredisë (ECL) për të gjitha instrumentet e borxhit që nuk mbahen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. ECL bazohen në diferencën ndërmjet flukseve monetare kontraktuale që duhet të paguhen në përputhje me kontratën dhe të gjitha flukse monetare që Shoqeira pret të marrë, te skontuara me një përafrim të normës fillestare të interesit efektiv. Flukset monetare pritet të përfshijnë flukset e mjeteve monetare nga shitja e kolateralit të mbajtur ose te ardhura te tjera që janë pjesë përbërëse e kushteve kontraktuale. Humbja nga zhvlerësimi i nje aktivi financiar te matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferenca midis vlerës kontabel dhe vlerës aktuale te flukseve monetare te vlerësuara te ardhshme te skontuara me normen fillestare te interesit efektiv te aktivit. Humbjet njihen ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese (fitim ose humbje) dhe pasqyrohen ne nje llogari zhvlerësimi perkundrejt llogarive te arketueshme. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdojne te njihen nepermjet skontimeve te pandryshueshme. Kur nje ngjarje pasuese ndikon ne uljen e shumes se zhvlerësimit, renia ne humbjen nga zhvlerësimi njihen ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese. Për të llogaritë e arkëtueshmet tregtare, Shoqëria zbaton një qasje të thjeshtuar në llogaritjen e ECLs. Si rrjedhojë, Shoqëria nuk ndjek ndryshimet në rrezikun e kredisë, por në vend të kësaj njeh një humbje nga zhvlerësimi të bazuar në jetgjatësinë e ECL-ve në çdo datë raportimi. Shoqëria ka krijuar një matricë provizionesh që bazohet në përvojën e saj historike të humbjeve nga kreditimi, të përshtatur për faktorët e ardhshëm që janë specifikë për debitorët dhe mjedisin ekonomik.

4.5 Aktivet dhe detyrimet finaciare

Shoqëria fillimisht njeh llogarite e arketueshme dhe depozitat monetare ne datën kur ato jane krijuar. Aktivet Financiare klasifikohen ne njohjen fillestar dhe maten me vone me kosto te amortizueshme, me vlere te drejtë nepermjet të ardhurat gjitheperfshirese (OCI), dhe me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes. Te gjitha aktivet e tjera financiare (duke perfshire aktivet e percaktuara me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes) njihen fillimisht ne datën e tregtimit ne te cilen Shoqëria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Shoqëria c'regjistron nje aktiv financiar kur te drejtat kontraktuale te flukseve te mjeteve monetare nga aktivi financiar mbarojne, ose kur transferon te drejtat per te marre flukse nga aktivi financiar ne nje transaksion ne te cilin kryesisht te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronesise se aktivit financiar jane transferuar. Çdo interes ne aktivet financiare te transferuara qe perfitohet ose mbahet nga Shoqëria është njohur si nje aktiv apo detyrim i vecante. Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet ne pasqyren e pozicionit financiar kur, dhe vetem kur, Shoqëria ka te drejte ligjore per te netuar shumat dhe synon ose te shlyeje mbi nje baze neto ose te realizoje aktivin dhe te shlyeje detyrimin ne te njejten kohe. Instrumentet financiare jo-derivative te Shoqërisë përfshijnë llogarite e kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme, mjetet monetare, dhe furnitoret dhe detyrime te tjera.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë parate e mbajtura ne bankat lokale ne monedhen vendase dhe te huaj dhe paraqiten me kosto

Llogari e kerkesa te arketueshme dhe Llogari e kerkesa te tjera te arketueshme

Llogarite e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv, duke minusuar provigjonet per zhvlerësim. Nje provigjon per zhvlerësimin i llogarive te arketueshmeve krijohet kur ka evidence objektive se Shoqëria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha shumat sipas kushteve fillestare te llogarive te arketueshmeve.
Veshtiresi te rendesishme financiare te debitorit, probabiliteti qe debitori do te hyje ne falimentim ose riorganizim financiar, dhe mospagesa ose veshtiresi ne pagesa konsiderohen si tregues se llogaria e arketueshme është zhvlerësuar.

Shuma e provigjonit është diferenca midis vlerës kontabel te aktivit dhe vlerës aktuale te flukseve te ardhshme te vlerësuara, te skontuara me normen fillestare te interesit efektiv. Aktivet me maturim te shkurter nuk jane skontuar. Vlera kontabel e aktivit zvogelohet nepermjet perdorimit te nje llogarie zbritje, dhe shuma e humbjes njihet ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese. Kur nje llogari e arketueshme është e pambledhshme, ajo është zbritur kundrejt llogarise se zhvlerësimit per llogarise e arketueshme. Rikuperimet pasuese te shumave te zbritura me pare jane kredituar ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese.

Furnitoret dhe detyrime te tjera

Furnitoret dhe detyrime te tjera jane pasqyruar fillimisht me vlere te drejte dhe me pas me koston e amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Huate dhe kredite

Huate dhe kredite maten fillimisht me vleren e drejte, neto per kostot e transaksionit. Detyrimet financiare maten me pas me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv, nderkohe qe shpenzimet e interesit njihen me normen efektive te interesit.
Metoda e interesit efektiv është nje metode e llogaritjes se kostos se amortizuar te nje detyrimi financiar dhe e regjistrimit te shpenzimeve te interesit gjate periudhes perkatese. Norma e interesit efektiv është norma qe skonton pagesat e ardhshme monetare te vlerësuara gjate jetes se pritshme te detyrimit financiar, ose, kur është e pershtatshme, gjate nje periudhe me te shkurter.

4.6 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat përfshijnë te ardhurat nga kryerja e sherbimeve. Te ardhurat maten duke ju referuar vlerës se drejte te shumes se marre ose te arketueshme nga Shoqëria per sherbimet te ofruara, duke perjashtuar taksat e shitjeve, rimbursimet, dhe skontot tregtare.
Shoqëria zbaton kriteret e njohjes se te ardhurave te percaktuara me poshte per secilin komponent te identifikueshem te transaksionit te shitjes per te reflektuar thelbin e transaksionit. Shuma e marre nga keto transaksione është ndare ne komponentin e vecante te identifikueshem duke marre parasysh vleren relative te drejte per çdo komponent. Te ardhurat njihen kur shuma e te ardhurave mund te matet ne menyre te besueshme, mbledhja është e mundshme, shpenzimet e bera ose qe do te behen te mund te maten me besueshmeri, dhe kur kriteret per secilin nga aktivitetet e ndryshme te Shoqërisë jane permbushur. Keto kritere njohje sipas aktiviteteve specifike jane te bazuara ne mallrat apo zgjidhjet e ofruara per konsumatorin dhe kushtet e kontrates ne çdo rast, dhe jane pershkruar me poshte:

Dhenia e sherbimeve
Te ardhurat nga shitja e sherbimeve jane njohur ne periudhen ne te cilen jane kryer sherbimet.

Te ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare
Te ardhurat financiare përfshijnë te ardhurat e interesit mbi fondet e investuara ne depozita bankare dhe fitimet ne valute te huaj.Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi huamarrjet, humbjet ne valute te huaj, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes, dhe humbjet e njohura nga zhvlerësimi i aktiveve financiare.

Fitimet dhe humbjet nga kembimi valutor raportohen ne baza neto.

4.7 Qeratë

Percaktimi nese nje marreveshje është ose permban terma qiraje, bazohet ne permbajtjen e marreveshjes ne datën e fillimit te saj, nese permbushja e marreveshjes ka te beje me perdorimin e aktivit, ose aktiveve specifike ose marreveshja percakton te drejten e perdorimit te aktivit, edhe pse e drejta nuk është shprehur qarte ne nje marreveshje.

Shoqëria si qiramarres
Qerate kontabilizohen sipas modelit "te se drejtes se perdorimit". Qirate te cilat transferojne tek Shoqëria ne menyre te konsiderueshme te gjitha rreziqet dhe perfitimet qe shoqerojne pronesine e aktivit te marre me qira, kapitalizohen ne momentin e fillimit te qirase me vleren e drejte. Pagesat e qirase shperndahen mes detyrimeve financiare dhe zvogelimit te detyimit te qirase, ne menyre qe te sigurohet nje norme interesi e qendrueshme ne balancen e mbetur te detyrimit. Detyrimet financiare njihen si kosto financiare ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese.

Nje aktiv i marre me qira financiare amortizohet pergjate jetes se dobishme te tij. Megjithate, nese ne fund te periudhes se qirase, nuk ekziston nje mundesi e arsyeshme qe Shoqëria te fitoje pronesine mbi aktivin, aktivi amortizohet pergjate periudhes me te shkurter midis jetes se dobishme te vlerësuar dhe kohezgjatjes se qirase.

Pagesat për qira afatshkurtra më pak se 12 muaj njihen si shpenzime operative në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Në mënyrë të ngjashme trajtohen edhe qiratë e aseteve me vlerë të ulët prej 5,000 Euro ose më pak. Asetet me vlerë të ulët përfshijnë kompjutera laptop, mobiljeve për zyra, telefona dhe pajisje të tjera me vlerë të ulët por përjashtojnë automjetet sepse një automjet i ri zakonisht nuk ka vlerë të ulët.

4.8 Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin llogaritet ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar mbi Tatimin mbi Fitimin. Tatimi mbi fitimin njihet ne fitim ose humbje per sa kohe qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital ose ne te ardhura te tjera gjitheperfshirese. Tatimi aktual është tatimi qe pritet te paguhet mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke perdorur normen tatimore ne fuqi ose substancialisht ne fuqi ne datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit te pagueshem per vitet e meparshme. Tatimi aktual mbi fitimin është llogaritur me 15% (2018: 15%) te fitimit te tatueshem.

Tatimi i shtyre është njohur duke perdorur metoden e bilancit kontabel, nga diferencat e perkohshme ndermjet vlerës kontabel te aktiveve dhe detyrimeve per qellime raportimi financiar dhe shumave te perdorura për qëllime fiskale. Tatimi i shtyre është matur ne norma te tatimit qe pritet te aplikohen ndaj diferencave te përkohshme kur ato te ndryshojne, bazuar ne ligjet që janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit.

Nje aktiv tatimor i shtyre njihet per sa kohe është e mundur qe fitimi i tatueshem i ardhshem te jete ne dispozicion kundrejt te cilit mund te perdoret ndryshim i perkohshem. Aktivet e tatimit te shtyre (nese ka) jane rishikuar ne secilen datë te raportimit dhe jane reduktuar deri ne masen ku nuk është e mundur qe perfitimet nga tatimi do te realizohen.

4.9 Përfitimet pas daljes në pension dhe planet e pensioneve

Shoqëria kryen vetem kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore qe ofrojne punonjesve perfitime pas daljes ne pension.Qeveria e Shqiperise është pergjegjese per percaktimin e limitit minimal ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit te pensioneve jane ngarkuar ne fitim ose humbje ne momentin kur ndodhin.

4.10 Kapitali

Kapitali aksioner perbehet prej mjeteve monetare te kontribuar nga Aksionari i Shoqërisë.

4.11 Provigjonet

Nje provigjon njihet kur Shoqëria ka nje detyrim aktual si rezultat i ngjarjeve te meparshme dhe është e mundur qe te kete nje dalje te burimeve qe perfaqesojne perfitimet ekonomike per te shlyer detyrimin, dhe mund te behet nje vlerësim i besueshem i shumes se detyrimit. Provigjonet rishikohen ne çdo datë te pozicionit financiar dhe rregullohen per te reflektuar vlerësimin me te mire aktual. Kur efekti i vlerës ne kohe te parase është material, shuma e provigjonit është vlera aktuale e shpenzimeve te pritshme te nevojshme per shlyerjen e detyrimit. Provigjonet nuk njihen per humbjet e ardhshme operative.

4.12 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen ne shenimet shpjeguese përveç rasteve kur mundesia e nje dalje te burimeve qe përfshijnë perfitime ekonomike është shume e ulet. Nje aktiv i kushtezuar nuk njihet ne pasqyrat financiare por është pasqyruar ne shenimet shpjeguese kur hyrja e perfitimeve ekonomike është e mundshme. Shuma e humbjes se kushtezuar Posta Shqiptare Sh.A është njohur si provigjon nese është e mundshme qe ngjarjet e ardhshme do te konfirmohen dhe se mund te behet nje vlerësim i arsyeshem i shumes se humbjes ne datën e pozicionit financiar.

4.13 Transaksionet e paleve te lidhura

Palet e lidhura jane ato ku njera nga palet është e kontrolluar nga tjetra, ose ka ndikim te rendesishem ne marrjen e vendimeve financiare apo te biznesit te pales tjeter. Shoqëria klasifikohet si një entitet i kontrolluar nga Qeveria, dhe përfiton nga përjashtimi i shënimeve shpjeguese për palët e lidhura.

4.14 Ngjarje pas periudhes së raportimit

Ngjarjet pas perfundimit te vitit te cilat japin informacione shtese per poziten e Shoqërisë ne datën e pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) jane reflektuar ne pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfundimit të vitit që nuk jane ngjarje rregulluese jane pasqyruar ne Shenime kur jane materiale.

5. Aktivet afatgjata materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri e paisje	Mjete transporti	Mobilje e orendi	Paisje informatike	AAM në proçes	Total
Kosto/Vlera e rivlersuar								
Me 01 Janar 2019	379,720,919	2,074,046,763	165,934,974	133,982,571	287,528,078	371,063,872	29,782,220	3,442,059,397
Rivlerësimi i aseteve	-60,878,605	494,066,278	26,738,540	29,326,529	31,166,965	40,669,611	-	561,089,318
Shtesa	-	-	106,858,368	-	30,751,086	125,744,592	50,818,092	314,172,139
Riklasifikim pas rivlerësimit	-	-	-75,400	-108,298	8.61	183,689	-	-
Transferime	-	-	38,000	-	-	-38,000	-29,300,000	-29,300,000
Sistemime	-	-	-	1,728,990	-	-	-	1,728,990
Pakësime	-	-	-1,727,990	-56,033	-3,034,583	-3,780,597	-	-8,599,203
Me 31 Dhjetor 2019	**318,842,314**	**2,568,113,041**	**297,766,492**	**164,873,759**	**346,411,554**	**533,843,168**	**51,300,312**	**4,281,150,640**
Zhvlersimi/Amortizim i akumuluar								
Me 01 Janar 2019	-	-514,191,082	-99,156,835	-76,509,954	-138,165,133	-200,508,244	-	-1,028,531,248
Amortizimi i vitit	-	-102,696,105	-16,124,715	-18,109,289	-32,269,972	-61,288,997	-	-230,489,078
Riklasifikim pas rivlerësimit	-	-2	-60,825	481,221	567,405	-987,798		-
Sistemime	-	-	-	-1,288,400	-	-	-	-1,288,400
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2019	**-**	**-616,887,189**	**-115,342,375**	**-95,426,422**	**-169,867,700**	**-262,785,039**	**0**	**-1,260,308,726**
Vlera kontabel neto 01.01.2019	379,720,919	1,559,855,681	66,778,139	57,472,617	149,362,945	170,555,628	29,782,220	2,413,528,149
Vlera kontabel neto 31.12.2019	**318,842,314**	**1,951,225,853**	**182,424,116**	**69,447,337**	**176,543,854**	**271,058,128**	**51,300,312**	**3,020,841,915**

Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata Materiale është bërë në 31 Dhjetor 2018 dhe është regjistruar në librat e Shoqërisë më 1 Janar 2019. Sipas raportit të eksperteve vlerësues AAM janë shtuar per një vlerë prej 561,089,318 Lekë. Shpenzimet e setup te Interposta prej 10,910,204 Lek nuk janë përfshirë si asete.

5. Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

	Toka	Ndërtesa	Makineri e paisje	Mjete transporti	Mobilje e orendi	Paisje informatike	AAM në proçes	Total
Kosto/Vlera e rivlersuar								
Me 01 Janar 2018	379,999,919	2,078,030,871	116,108,832	146,784,848	271,382,606	391,026,012	-	3,383,333,088
Shtesa	-	-	6,966,126	-	39,849,820	78,281,470	29,782,220	154,879,636
Transferime	-	-	4,028,617	-	-8,460,139	4,431,522	-	-
Sistemime interposta	-	-	-12,340,610	-	-12,010,300	-208,001,536	-	-232,352,446
Shtesa Interposta	-	-	58,810,684	-	10,873,960	112,216,305	-	181,900,949
Pakësime	-279,000	-3,984,108	-7,638,675	-12,802,277	-14,107,869	-6,889,901	-	-45,701,830
Me 31 Dhjetor 2018	**379,720,919**	**2,074,046,763**	**165,934,974**	**133,982,571**	**287,528,078**	**371,063,872**	**29,782,220**	**3,442,059,397**
Zhvlersimi/Amortizim i akumuluar								
Me 01 Janar 2018	-	-432,704,340	-63,801,816	-72,396,411	-122,835,525	-249,929,039	-	-941,667,131
Amortizimi i vitit	-	-82,266,331	-7,522,102	-14,024,988	-26,347,948	-21,805,708	-	-151,967,077
Sistemime interposta	-	-	8,042,977	1,061,663	6,093,369	141,075,289	-	156,273,298
Shtesa Interposta	-	-	-38,352,283	-	-7,142,265	-75,034,225	-	-120,528,773
Transferime	-	-	-2,713,881	-	2,615,603	98,278	-	-
Pakësime	-	779,589	5,190,270	8,849,782	9,451,633	5,087,161	-	29,358,435
Me 31 Dhjetor 2018	**-**	**-514,191,082**	**-99,156,835**	**-76,509,954**	**-138,165,133**	**-200,508,244**	**-**	**-1,028,531,248**
Vlera kontabel neto 01.01.2018	379,999,919	1,645,326,531	52,307,016	74,388,437	148,547,081	141,096,973	-	2,441,665,957
Vlera kontabel neto 31.12.2018	**379,720,919**	**1,559,855,681**	**66,778,139**	**57,472,617**	**149,362,945**	**170,555,628**	**29,782,220**	**2,413,528,149**

6. Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jo-materiale jane analizuar si me poshte:

	AAJM	AAJM në proçes	Totali
Kosto/Vlera e rivlersuar			
Me 1 Janar 2019	115,271,753	-	115,271,753
Rivlerësim i aseteve	34,736,970	-	34,736,970
Shtesa	-	999,721	999,721
Transferime	-	29,300,000	29,300,000
Pakësime	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2019	**150,008,723**	**30,299,721**	**180,308,443**
Amortizimi			
Me 1 Janar 2019	-57,757,443	-	-57,757,443
Amortizimi i vitit	-13,814,106	-	-13,814,106
Sistemim	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2019	**-71,571,549**	**-**	**-71,571,549**
Vlera neto kontabel 1 Janar 2019	57,514,310	-	57,514,310
Vlera neto kontabel 31 Dhjetor 2019	**78,437,174**	**30,299,721**	**108,736,894**

	AAJM	AAJM në proçes	Totali
Kosto/Vlera e rivlersuar			
Më 1 janar 2018	115,112,313	-	115,112,313
Shtesa Interposta	159,440	-	159,440
Pakësime	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2018	**115,271,753**	**-**	**115,271,753**
Amortizimi			
Më 1 janar 2018	-47,636,175	-	-47,636,175
Amortizimi i vitit	-10,172,743	-	-10,172,743
Sistemim	51,475	-	51,475
Me 31 Dhjetor 2018	**-57,757,443**	**-**	**-57,757,443**
Vlera neto kontabel 1 Janar 2018	67,476,138	-	67,476,138
Vlera neto kontabel 31 Dhjetor 2018	**57,514,310**	**-**	**57,514,310**

Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata Jo-Materiale është bërë në 31 Dhjetor 2018 dhe është regjistruar në librat e Shoqërisë më 1 Janar 2019. Sipas raportit të eksperteve vlerësues AAJM janë shtuar per një vlerë prej 34,736,970 Lekë. Shtesat gjatë vitit 2019 lidhen me programin information Eterna që po implementohet.

7. Aktivet afatgjata financiare

Aktivet financiare përfshijne investimin që Shoqëria ka bërë tek Albtelecom sha

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Investime në Shoqërinë Albtelecom sha	450,000,000	450,000,000
Totali	**450,000,000**	**450,000,000**

Më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 Shoqëria zotëron 450,000 aksione apo 2.47% të kapitalit aksioner të Albtelecom sha me vlerë të regjistruar në Qëndrën Kombetare të Biznesit (QKB) prej 450,000,000 Lek.

8. Inventari

Gjendja e inventarit më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Materiale të para	32,872,347	13,924,429
Materiale ndihmëse	91,689,121	109,169,121
Lëndë djegëse	3,501,468	4,055,726
Pjesë këmbimi	8,202,695	98,010
Inventar i imët	54,261,651	62,607,771
Mallra për shitje	49,407,751	30,814,733
Totali	**239,935,033**	**220,669,790**

9. Llogari të arkëtueshme tregtare

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Klientë për shitje e shërbime	405,264,413	305,915,752
Klientë OSHEE	508,132,713	502,356,240
Kliente nderkombëtar	147,801,665	122,390,917
Provigjone per borxhin e keq	-15,711,650	-
Totali	**1,045,487,141**	**930,662,909**

10. Llogari të arkëtueshme të tjera

Llogari të arkëtueshme të tjera jane detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të arkëtueshme nga Banka e Shqipërisë për Bono Thesari	80,550,000	89,070,000
Tatim fitimi i parapaguar	14,255,131	8,854,641
TVSH e parapaguar Interposta	58,285,911	58,285,911
TVSH e arkëtueshme	-	4,240,038
Të drejta ndaj personelit	125,441,634	103,971,457
Provigjone per të drejtat ndaj personelit	-20,761,277	-
Debitorë të tjerë marrëdhënie me sportelin	79,891,835	45,953,519
Të tjera kërkesa	43,966,860	44,427,099
Totali	**381,630,095**	**354,802,665**

11. Parapagime dhe shpenzime te shtyra

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Parapagime per furniture per TVSH	10,809,227	-
Shpenzime te periudhave te ardhshme	2,534,879	7,792,000
Totali	**13,344,106**	**7,792,000**

12. Mjetet monetare dhe likuditete të tjera

Mjetet monetare jane si vijon:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Llogari rrjedhëse ne banka		
- ne monedhe vendase	1,292,791,586	977,174,442
- ne monedhe te huaj	273,581,668	305,409,875
	1,566,373,254	**1,282,584,317**
Arka		
- ne monedhe vendase	850,614,357	748,519,595
- ne monedhe te huaj	14,378,082	6,760,046
	864,992,439	**755,279,641**
Pulla postare	66,595,678	79,249,338
Pulla takse	85,082,300	63,518,342
Te tjera likuiditete	75,765,272	9,092,801
Totali i mjeteve monetare dhe likuditete të tjera	**2,658,808,944**	**2,189,724,439**

13. Kapitali dhe rezervat

Kapitali

Me 31 Dhjetor 2019 dhe 2018, sipas Qendres Kombetare te Biznesit (QKB) totali i kapitalit te regjistruar është 3,006,363,000 Lekë.

	2019	%	2018
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes	3,006,363,000	100	3,006,363,000
Totali i Kapitalit të Regjistruar	**3,006,363,000**	**100**	**3,006,363,000**

Rezerva te tjera

Balanca e rezerva te tjera është krijuar në vitet e meparshme dhe ne 31 Dhjetor 2019 është 126,507 Lekë (2018: 126,507 Lekë).

Rezerva ligjore

Rezervat ligjore jane krijuar ne perputhje me "Ligjin per Shoqerite Tregtare" që lejon Shoqërinë të krijoj rezerve ligjore. Balanca e rezerva ligjore me 31 Dhjetor 2019 është 120,809,791 Lekë (2018: 117,568,841 Lekë).

Rezerva Rivlerësimi

Rezervat e rivlerësimit janë krijuar sipas rivlerësimeve që shoqëria ka kryer në lidhje me aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale. Balanca e rezerva të rivlerësimit më 31 Dhjetor 2019 është 1,715,249.484 Lekë (2018: 1,138,684,252 Lekë).

Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata Materiale është bërë në 31 Dhjetor 2018 dhe është regjistruar në librat e Shoqërisë më 1 Janar 2019. Sipas raportit të eksperteve vlerësues rezerva e rivlerësimit është shtuar për vlerën 686,844,657 Lekë duke përfshirë edhe sistemimet në lidhje me kalim në fitime të mbartura të rezervës negative të mbartur nga rivlerësimet e mëparshme prej 18,462,267 Lekë dhe zgovëlimin e rezervës për asetet e dala jashtë përdorimit në periudhat e mëparshme prej 9,308,890 Lekë.

Fitimet e mbartura

Balanca e fitimeve të mbartura është krijuar nga fitimi i pashperndare i viteve të mëparshme si edhe rregullimet kontabël ne lidhje me tatimin e shtyrë apo rivlerësimet e aseteve, ne 31 Dhjetor 2019 është 155,465,930 Lekë (2018: 310,674,676 Lekë).

14. Tatim i shtyrë

Tatimi i shtyrë i përllogaritur pasqyrohet si mëposhtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Rivlerësimi I aktiveve afatgjata materiale	239,995,576	168,513,547
Detyrime tatimore të shtyra	**239,995,576**	**168,513,547**
Rregullimet gjatë vitit		
Rritja e vlerës se aseteve nga rivlerësimit	-89,373,943	-
Të ardhura (shpenzime) tatim i shtyre	17,891,914	1,571,220
Totali	**-71,482,029**	**1,571,220**

15. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshem tregtare përfshijnë kryesisht detyrimet kundrejt furnitoreve vendas.

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Furnitore vendas	1,093,830,707	474,265,502
Furnitorë për fatura të pambëritura	-	641,560
Totali	**1,093,830,707**	**474,907,062**

Llogarite e pagueshem tregtare nuk mbartin interes dhe janë zakonisht në kushte 30 ditore.

16. Detyrime tatimore

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Detyrime për sigurime shoqërore	29,149,110	24,477,307
Tatim mbi të ardhurat personale	3,478,771	7,377,903
TVSH për t'u paguar	3,954,273	-
Tatim në burim	403,928	509,615
Totali	**36,986,082**	**32,364,825**

Taksat dhe tatimet zakonisht shlyhen nga 10 deri ne 20 dite nga mbyllja e muajit. Sigurimet shoqerore dhe shëndetesore shlyhen jo më vonë se 20 dite pas mbylljes se muajit.

17. Detyrime ndaj punonjësve

Detrimet për paga përfshijnë pagat e muajit Dhjetor 2019 të cilat nuk janë paguar.

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Detyrime për paga	2,718,248	6,347,106
Te tjera detyrime	-	157,749
Totali	**2,718,248**	**6,504,855**

18. Grante dhe të ardhura të shtyra

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të ardhura të shtyra	7,176,717	7,247,008
Totali	**7,176,717**	**7,247,008**

19. Llogari të pagueshme të tjera

Te tjera te pagueshme përfshijnë zerat e meposhtem:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Detyrime për bono thesari	80,550,001	89,070,000
Detyrime për pensione	671,946,027	565,089,076
Detyrime per sherbimin nderkombetar	62,439,924	42,826,677
Detyrime per ndihme ekonomike	65,229,873	32,781,992
Detyrime per invaliditet	10,208,727	48,324,188
Detyrime ndaj drejtorive arsimore	25,832,504	38,261,196
Detyrime ndaj njesive administrative	1,497,220	25,042,529
Detyrime te tjera ndaj bashkive	369,110,717	246,411,010
Detyrime ndaj OSHEE	193,876,602	139,281,074
Detyrime të tjera	59,370,492	134,651,947
Totali	**1,540,062,087**	**1,361,739,689**

20. Të ardhura

Të ardhura janë të detajuara si me poshte:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të ardhura nga shërbime postare	1,153,328,284	1,042,578,784
Të ardhura nga shërbime financiare	1,171,404,669	1,066,563,383
Të ardhura nga shërbime biznesi	66,453,721	55,740,646
Të ardhura nga shërbimi ekspres	145,180,700	143,215,051
Të ardhura nga shërbimi ndërkombëtar	237,113,911	202,122,664
Te ardhura nga eksporti	11,032,967	5,071,555
Totali	**2,784,514,253**	**2,515,292,083**

21. Të ardhura të tjera

Të ardhura e tjera janë paraqitur si më poshtë.

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Te ardhura të tjera	1,431,470	91,683
Totali	**1,431,470**	**91,683**

22. Materiale të para dhe të konsumueshme

Shpenzimet për materialet e para dhe të konsumueshme paraqiten si vijon:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Materiale të konsumuara	113,371,059	97,375,424
Kosto e pullës	15,680,488	8,426,813
Konsumi i iventarit të imët	23,445,433	4,945,072
Shpenzime karburanti	48,596,617	53,825,505
Koefiçienti i kreditimit	182,277,572	77,730,980
Totali	**383,371,168**	**242,303,794**

Shpezimet e koefiçientit të kreditimit lidhet me TVSH e pa zbritshme në blerje.

23. Shpenzime personeli

Shpenzimet per personelin përfshijnë si vijon:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Shpenzime për paga	1,196,094,076	1,144,529,172
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	198,967,888	190,036,778
Shpërblime për punonjësit	4,697,171	43,615,054
Totali	**1,399,759,134**	**1,378,181,004**

Numri mesatar i punonjësve për vitin 2019 ishte 2,464.

24. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera përbëhen nga:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Shpenzime për ruajte objektesh	200,918,525	93,110,807
Shpenzime postare ndërkombëtare	110,829,032	98,566,236
Shpenzime personel i jashtëm	66,950,479	22,246,810
Shpenzime për komisione bankare	55,496,203	67,130,704
Shpenzime penalitete dhe dëmshperblime	54,037,310	27,940,521
Shpenzime të tjera	43,176,003	25,663,272
Shpenzime për reklama dhe publicitet	38,707,569	12,137,768
Shpenzime për energji elektrike dhe uje	37,278,429	41,463,728
Shpenzime për borxhin e keq	36,472,927	-
Shpenzime qeraje	32,910,318	28,613,850
Shpenzime për mirëmbajte dhe riparime	32,657,233	13,105,889
Shpenzime per mirembajtje sistem sigurie dhe IT	30,244,725	50,202,697
Shpenzime për taksa	29,399,036	30,337,018
Shpenzime për udhëtime dhe dieta	28,751,968	27,742,270
Blerje sherbim internet	24,759,831	44,738,496
Shpenzime për sponsorizime dhe ndihma	14,620,325	4,719,000
Shpenzime për liçensa/kuotizacione	8,892,826	12,547,654
Shpenzime transport	7,531,275	6,488,047
Vlera e mbetur e AAM-ve të dala	6,023,050	12,857,798
Shpenzime telefonike	4,033,880	4,401,611
Shpenzime siguracioni	1,132,966	1,345,310
Shpenzime pritje, dhurata	726,715	2,663,308
Shpenzime për agjent postar	-	336,270
Totali	**865,550,624**	**628,359,064**

25. Të ardhurat/(shpenzimet) financiare

Te ardhurat/(shpenzimet) financiare përfshijnë fitimet dhe humbjet e realizuara apo të parealizuara nga kurset e kembimit, te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat, dhe te tjera te ardhura financiare si vijon:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Fitim nga këmbimet valutore	6,594,877	44,108,690
Humbje nga këmbimet valutore	-7,053,211	-57,993,474
Fitime (humbjet) neto nga kurset e kembimit	**-458,334**	**-13,884,784**
Të ardhura nga interesat	1,485,373	1,897,664
Shpenzime per interesa	-60,108	-139,943
Te ardhurat neto nga interesi	**1,425,264**	**1,757,721**
Të tjera financiare	42,273,132	2,520,961
Totali i te ardhurave/(shpenzimeve) financiare neto	**43,240,062**	**-9,606,102**

26. Humbja në vlerë nga rivlerësimi

Shoqëria ka kryer rivlerësim të aseteve dhe humbjet nga rivlerësimi i aseteve janë njohur si shpenzime të periudhës.

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Zhvleftësimi i aseteve	-104,548,194	-
Te ardhura nga rivlersimi I aseteve	2,774,418	-
Humbje nga rivlerësimi i aseteve	**-101,773,776**	**-**

Humbja nga renia ne vlere e aktiveve e aktiveve është njohur në rezultatin e Shoqërisë në raportin e vlerësimit të datës 31.12.2018.

27. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatim fitimit rakordon me fitimin kontabël per vitin 2019 dhe 2018 si me poshte:

		31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Fitimi/(Humbja) para tatimit	(165,572,103)	94,796,135
2	Shpenzime te panjohura:	**315,327,733**	**105,051,490**
	-Shpenzime amortizimi	116,703,060	59,105,420
	-Penalitete, gjoba e demshperblime	40,061,768	26,759,300
	-Tatim fitimi nga vite te shkuara	8,683,107	-
	-Shpenzime dhurata e sponsorizime	9,706,000	-
	-Shpenzime per dalje jashte perdorimit	1,200,380	-
	-Shpenzime provigjoni	36,472,927	-
	-Humbje nga zhvlereim e aseteve	101,773,776	-
	-Shpenzime pritje percjellje	726,715	2,663,820
	-Shpenzime të tjera	-	16,522,950
	Fitimi / (humbje) e tatueshme (1+2)	**149,755,629**	**199,847,625**
3	Humbje te mbartura (-)	-	-
4	Fitimi i tatueshem **(1+2+3)**	149,755,629	199,847,625
	Norma e tatimit mbi fitimin	15%	15%
5	**Shpenzim tatim fitimi**	**22,463,344**	**29,977,144**

28. Manaxhimi i riskut financiar

28.1 Faktoret e riskut financiar

Aktivitetet e Shoqërisë e ekspozojne ate ndaj rreziqeve financiare, duke perfshire riskun e kredise dhe risqet qe lidhen me efektet e ndryshimeve ne kurset e kembimit dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut te Shoqërisë fokusohet ne paparashikueshmerine e tregjeve dhe kerkon te minimizoje efektet e mundshme negative mbi ecurine e biznesit te Shoqërisë.

Menaxhimi i riskut kryhet nga Drejtimi bazuar ne politikat dhe procedurat qe mbulojne menaxhimin e riskut te pergjithshem, si dhe tipe te vecanta, te tilla si risku nga kursi i kembimit, risku i normes se interesit, risku i kredise, perdorimi i letrave me vlere te pershtatshme dhe investimi i likuiditetit te tepert.

28.2 Riksu i tregut

Risku i kursit te kembimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut te kursit te kembimit qe vjen nga kembimet ne monedha te ndryshme kryesisht ne lidhje me Euro dhe USD. Shoqëria nuk perdor ndonje instrument per tu mbrojtur nga risku i kembimit valutor. Drejtimi i Shoqërisë është pergjegjes per te mbajtur nje gjendje te duhur neto ne çdo monedhe dhe ne total dhe te monitoroje operacionet e perditshme.

Risku i norms se interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Ekspozimi i Shoqerisë ndaj rrezikut të ndryshimeve në normat e interesit të tregut është minimal dhe ka të bëjë kryesisht me depozitat e Shoqërisë.

28.3 Risku i kreditit

Shoqëria ka risk te kreditit nga natyra e aktivitetit pasi jo te gjitha shitjet jane me para ne dore.Gjithashtu, risku i kreditit qe vjen nga aktivet e tjera financiare te Shoqërisë, te cilat përfshijnë mjetet monetare dhe llogari të arkëtueshme të tjera të cilat lidhen me vonesat ne pagesa te pales tjeter, me nje ekspozim maksimal te barabarte me vleren kontabel të ketyre instrumenteve

	2019	**2018**
Vlerat e klasave te aktiveve financiare:		
Mjetet monetare	1,566,373,254	1,282,584,317
Llogari të arkëtueshme tregtare	1,061,198,791	930,662,909
Llogari të arkëtueshme të tjera	329,850,329	283,422,075
Totali	**2,957,422,375**	**2,496,669,301**

28.4 Risku i likuiditetit

Shoqëria menaxhon nevojat e saj per likuiditet duke monitoruar me kujdes pagesat e planifikuara per detyrimet afatgjata financiare si dhe te parashikoje flukset monetare gjate aktiviteteve te perditshme. Nevojat per likuiditet jane te monitoruara ne grupe te ndryshme kohore. Kerkesa neto per mjete monetare është krahasuar me provigjonet per huamarrje ne dispozicion ne menyre qe te percaktohet ndonje mungese. Kjo analize tregon nese huamarrja ne dispozicion pritet te jene te mjaftueshme gjate periudhes ne fjale. Shoqëria mban mjete monetare per te permbushur kerkesat e likuiditetit per periudha minimum 30-ditore.

Me 31 Dhjetor 2019 dhe 2018, detyrimet e Shoqërisë kane maturime kontraktuale të permbledhura si me poshte:

	Afatshkurter		Afatgjate	
Me 31 Dhjetor 2019	1 deri 12 muaj	1 deri 2 vjet	2 deri 5 vjet	Me shume se 5 vjet
Llogari te pagueshme tregtare	1,093,830,707	-	-	-
Detyrime tatimore	36,986,082	-	-	-
Detyrime ndaj punonjesve	2,718,248	-	-	-
Llogari te tjera te pagueshme	1,540,062,087	-	-	-
	2,673,597,124	**-**	**-**	**-**

	Afatshkurter		Afatgjate	
Me 31 Dhjetor 2018	1 deri 12 muaj	1 deri 2 vjet	2 deri 5 vjet	Me shume se 5 vjet
Llogari te pagueshme tregtare	474,907,062	-	-	-
Detyrime tatimore	32,364,825	-	-	-
Detyrime ndaj punonjesve	6,504,855	-	-	-
Llogari te tjera te pagueshme	1,361,739,689	-	-	-
	1,875,516,431	**-**	**-**	**-**

Vlerat me siper jane te barabarta me detyrimet kontraktuale te paskontuara te cilat mund te jene te ndryshme nga vlera kontabel e detyrimeve ne datën e raportimit.

28.5 Menaxhimi i riskut te kapitalit

Objektivat kryesore te Shoqërisë ne menaxhimin e kapitalit jane ruajta e aftesise se Shoqërisë per te ofruar ne menyre te vazhdueshme te ardhura per aksioneret dhe perfitime per investitoret e tjere dhe te ruaje nje strukture kapitali optimale per te redukturar koston e kapitalit. Ne menyre qe te ruhet dhe rregullohet struktura e kapitalit, Shoqëria mund te rregulloje shumen e dividendeve te paguar aksionereve, ktheje kapital aksionereve, emetoje aksione te reja ose te shese aktive per te reduktuar borxhin.

Gearing ratio (Raporti Borxh/Kapital)

Struktura e kapitalit te Shoqërisë, perfshin detyrimet, mjetet monetare dhe kapitalin, i cili perfshin kapitalin aksioner dhe fitimin e pashperndare ose humbjet e akumuluara. Drejtimi rishikon strukturen e kapitalit ne baze vjetore si nje lidhje midis detyrimeve neto te kredive dhe kapitalit total. Detyrimet neto te kredive llogariten si nje diference midis detyrimeve totale per huamarrje me vleren e mjeteve monetare.

Treguesi i borxhit ne fund te vitit është si me poshte:

	2019	**2018**
Llogari te pagueshme tregtare	1,093,830,707	474,907,062
Llogari te tjera te pagueshme	1,579,766,417	1,400,609,369
Mjete monetare	-2,431,365,694	-2,037,863,958
Detyrime neto	242,231,430	-162,347,527
Kapitali	4,998,014,712	4,573,417,276
Gearing ratio (Raporti Borxh/Kapital)	**0.05**	**(0.04)**

29. Angazhimet dhe detyrime te kushtezuara

Angazhime
Shoqëria nuk ka angazhime materiale te nenkontraktuara ne datën e pasqyres se pozicionit financiar te cilat te mos jene reflektuar ne pasqyrat financiare

Detyrime tatimore
Librat dhe te dhenat kontabel per vitet financiare qe perfundojne me 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 nuk jane audituar nga autoritetet tatimore. Si rrjedhim, detyrimet tatimore te Shoqërisë mund te mos konsiderohen te finalizuara.

Çështje gjyqësore
Me 31 dhjetor 2019, shoqëria ka disa veprime ligjore të ngritura kundër Shoqerisë nga punonjes apo të tretë. Shuma e vlerësuar ne Lekë i çështjeve gjyqesore per padi te ngritura ndaj Shoqërisë është 71,177 mije Lekë.
Gjithashtu, Shoqëria ka në perdorim disa ambjente te cilat jane pjese e kapitalit te Shoqërisë Albtelekom sha, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, në cilësine e aksionerit me shkresen nr.56081 datë 01.11.2010 dhe Urdhrin nr.546 datë 11.06.2013 ka kërkuar dorezimin e tyre tek Shoqëria Albtelekom dhe heqjen perfundimisht nga lista e pasurive te paluajtshme te Shoqërisë. Drejtimi i Shoqërisë ka pretendime ne lidhje me pronësinë e ambjenteve dhe për rrjedhoje ka nisur veprime ligjore.

30. Ngjarje pas datës së raportimit

Në fund të vitit 2019 dolën për herë të parë lajmet nga Kina në lidhje me COVID-19 (Coronavirus). Situata në fund të vitit ishte se një numër i kufizuar i rasteve të një virusi të panjohur ishin raportuar në Organizatën Botërore të Shëndetit. Gjatë vitit 2020 virusi ishte përhapur globalisht dhe ndikimi i tij negativ ka fituar një impuls. Manaxhimi e konsideron që informacion të jetë një ngjarje jo rregulluese pas datës së raportimit. Ndërsa kjo është ende një situatë në zhvillim në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare, deri më tani nuk ka pasur ndonjë ndikim të dukshëm në operimet e Shoqërisë, megjithatë efektet e ardhshme nuk mund të parashikohen. Manaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjithë hapat e mundshëm për të zbutur çdo efekt.

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.